



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-080

Prishtinë, më 22 tetor 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 22 TETOR 2012

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti dhe Sabri Hamiti, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani dhe Sasha Milosavleviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi, Bilall Sherifi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Shefqet Rexhepi;

Nga Zyra e Presidentit: Amir Haradinaj dhe
Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 15 tetor 2012,
2. Konfirmimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

* * *

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 15 tetor 2012

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 15 tetor 2012.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës:

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e Kuvendit të mbahet të enjten, më 1 nëntor 2012, me këtë:

R e n d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e amendamentit të neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar për reformën e Bordit Ekzekutiv,
5. Votimi i Projektligjit për rritjen e kuotës së Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për odat e profesionistëve shëndetësorë,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kontrollin e duhanit,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sistemin e pagesave,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zonat ekonomike
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme,
12. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të punës,
13. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Auditimit për vitin 2011,
14. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e tre anëtarëve në Bordin për Ankesa të Medieve.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe kërkesave:

1. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës lidhur me zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimimit nga Tatimi i Vlerës së Shtuar deri më 31 dhjetor 2014

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimeve nga Tatimi i Vlerës së Shtuar deri më 31 dhjetor 2014, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision funksional, që ta shqyrtojë Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 06/94 të datës 10 tetor 2012, për zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimimit nga Tatimi i Vlerës së Shtuar deri më 31 dhjetor 2014 dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

2. Njoftimi për dorëheqjen e disa deputetëve të Kuvendit nga grupet parlamentare

Kryesia, pasi u njoftua lidhur për dorëheqjen e disa deputetëve të Kuvendit nga grupet parlamentare, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Shërbimi i Deputetëve që t’i njoftojë deputetët që janë larguar nga grupet parlamentare se, në bazë të nenit 20.2 të Rregullores së Kuvendit, duhet ta njoftojnë me shkrim kryetarin e Kuvendit për vendimin e tyre.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale